Kronikë

Krushku sulmon me breshëri automatiku banesën e vjehrrit të djalit, Policia e Divjakës e arreston! Detajet e para të krimit

Konflikti mes dy familjeve me lidhje krushqie për pak sa nuk mbyllet me tragjedi në fshatin Havaleas. I dyshuari kapet në banesën e tij në fshatin Karavasta e Re, i sekuestrohen automatiku dhe municionet

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
10 Gusht, 12:03 | **Përditesimi: 10 Gusht, 12:13**

Share

Divjakë- Një krim në familje është parandaluar nga Policia e Fierit, teksa shënjestrat e sulmit i ndihmoi vetëm fati nga plumbat e parë të qitur prej agresorit.

I dyshuari **Petraq Sotiri**, nga fshati Karavasta e Re e Divjakës, u prangos nga uniformat blu, pak momente pasi lëshoi breshëri automatiku në drejtim të banesës së vjehrrit të djalit të tij, në një konflikt të dyshuar dhe të vazhdueshëm mes palëve. Krimi ndodhi në fshatin Havaleas.

Policia vendore konfirmoi ngjarjen dhe njoftoi se sekuestroi armën e krimit. Denoncimi për sulmin ishte bërë nga vetë pronari i shtëpisë pas plumbave që shkaktuan vetëm dëme materiale dhe panik.

LEXO EDHE:
Mbytet 69-vjeçari në plazhin Pishporo në Fier! Pësoi infarkt sapo u fut në det

Policia e Fierit në njoftimin zyrtar për ngjarjen shprehet:

"Në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Divjakë, dhe falë inteligjencës policore u bë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit: P. S., 63 vjeç, banues në fshatin Karavasta e Re, Divjakë".

Dhe më tej detajon dinamikën dhe rrethanat, duke shtuar se "ky shtetas dyshohet se pas konflikteve të vazhdueshme familjare me vjehrrin e djalit të tij, ka qëlluar drejt banesës së këtij të fundit me automatik duke kanosur atë dhe familjarët".

Uniformat blu ushtruan edhe kontroll në banesën e 63-vjeçarit, ku sekuestruan armën automatike dhe një sasi municioni luftarak. Hetimet janë ende aktive, teksa po sqarohen motivet e përplasjeve mes dy familjeve me krushqi, pasi nuk jepen detaje nëse shkak ka qenë ndonjë divorc i fëmijëve të dy protagonistëve të konfliktit.

A.Q/A.M/Shqiptarja.com

TAG: petraq sotiri | arrestim | divjakë | Fier

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si po përballohet situata e krijuar nga zjarret në vend?

Mirë | Keq | Nuk e di

Lajme të tjera

U kapën me drogë më 2022, Prokuroria e Fierit çon në gjyq babë dhe bir për pastrim parash! Iu gjendën mbi 88 mln lekë cash dhe 6 makina (Emrat)
9 Gusht, 11:20

Pogradec/ Kultivim bimësh narkotike dhe municion luftarak me vete, policia arreston 31 vjeçarin (EMRI)
8 Gusht, 15:36

Report tv zbardh detaje nga aksidenti në punë/ Punëtori egjiptian punonte në shtyllën e tensionit të lartë pa litarin e shpëtimit
8 Gusht, 12:28

Patos, punëtori egjiptian 37 vjeç bie nga shtylla e tensionit të lartë dhe ndërron jetë! Ka të shoqëruar në polici
7 Gusht, 21:07

Berat/ Përfshihet nga flakët një sipërfaqe me ullishte në fshatin Sinjë (VIDEO)
7 Gusht, 19:03

Ngrihet stacioni i ri zjarrfikës në Fier, ministri Hoxha: Ligj të ri dhe riorganizim të Shërbimit Zjarrfikës
7 Gusht, 15:10

Nga vazot e luleve deri tek lavazhet, çfarë duhet të dini për Ethet e Nilit dhe mushkonjat, para se të alarmoheni! Flet shefja e Epidemiologjisë në Fier
7 Gusht, 13:24

'Apolonia' magjepsëse për turistët e huaj, numërohen 68 500 vizitorë për 7 muaj ! Turisti spanjoll: Ju keni shumë histori mbresëlënëse
Kristaq Thano
5 Gusht, 09:51

Lejoi ndërtimet pa leje, kryeinspektori i Bashkisë së Divjakës dënohet me 1 vit burg
3 Gusht, 10:20

Në kërkim për prodhim dhe shitje droge, dy në pranga në Fier
2 Gusht, 10:45

Aksident në aksin Levan-Tepelenë, mjeti del nga rruga dhe përfundon në kanal! Humb jetën shoferi
1 Gusht, 21:03

Fier/ Shuhet zjarri pranë ish-repartit ushtarak, u dëgjuan dhe shpërthime municionesh (VIDEO)
1 Gusht, 12:19

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje